

Karta e apostollit Pavël mbë Titonë.

Krye 1.

- 1 Pavli, shërbëtuar i Perëndisë, edhe apostoll i Jisu Krishtit, pas besës' së të-sgjedhurëvet të Perëndisë, edhe pas të-njohurit të
- 2 së-vërtetësë që është pas besës' së-mirë, Me shpresë për jetën' e-përjetëshme, të-cilën' u-zotua Perëndia që s'gënjen përpara kohëra-
- 3 ve të-përjetëshme, Edhe çfaq i ndë kohëra të-ndara fjalën' e ti me anë të të-lëçiturit që m'u-besua mua pas urdhërit të Shpëtimtarit t'ënë
- 4 Perëndi; Mbë Titonë, të-thjeshtinë djalë pas besës's'ënë së-bashkëtë, hir *qoftë*, (përdëllim,) paqtim prej Perëndisë, Atit, edhe prej Zotit t'ënë Iisu Krishtit, Shpëtimtarit t'ënë.
- 5 Përandaj të lashë ndë Krittë, që të ndreqq të-metatë, edhe të vësh mbë çdo qytet pleq

- 6 sikundrë të urdhërova unë; Kush të jetë i-pahequrë për faj, burrë i një gruaje, që ka bij besëtarë që s'përflitenë për plank-prishës,
- 7 a për të-pabindurë. Sepse episkopi duhetë të jetë i-pahequrë për faj, posi kujdestar i Perëndisë; jo i-vrazhëtë, jo zëmërak, jo dejmarak, jo ngrindës, jo *njeri* që lakmon mbë
- 8 fitim të-lik; Po dorë-hapëtë, mirë-dashës, i-urtë, g i-drejtë, shënjt, i-përmbajturë; I-ngjiturë pas fjalës' së-vërtetë pas mësimit *që mori*, që të muntnjë edhe të ngutnjë *të-tjerë* me anë të mësimit të-shëndoshë, edhe të qërtonjë ata që flasënë kundrë.
- 10 Sepse janë shumë të-pabindurë që flasënë *fjalë* të-kota e që prishnjënë mëndjenë, më
- 11 fort ata që janë nga rrethpresja; Të-cilëvet duhetë t' u mbyllmë gojënë; të-cilëtë përmbysnjënë shtëpira të-tëra, dyke mësuarë sa
- 12 nukë duhenë, per fitim *të tyre* të-ndyrë. Një nga ata, profit i atyreve, tha, "Kritasitë janë gjithënjë gënjeshtarë, bisha të-liga, barqe të-ngeshim.,"
- 13 Ky dëshmim është i-vërtetë; për të-cilënë ngajë qërto-i ata ashpërë, që të shëndoshenë
- 14 ndë besët; Edhe të mos u vënë vesh përrelavet të Judhenjvet, edhe porosivet të nje-
- 15 rësvet që mërziinjënë të-vërtetënë. Te të-qëruaritë të-gjitha janë të-qëruara; po ndë të-pëgëret e ndë të-pabesët asgjë s' është e-qëruarë, po edhe mëndja e atyreve edhe ndër-

16 gjegja janë të-pëgëra. Rrëfenjënë me gojë se njohënë Perëndi, po me punëratë e mohojnënë, sepse janë të-ndyrë edhe të-pabindurë, edhe mbë çdo punë të-mirë të-paprovuarshim.

Krye 2.

1 Po ti folë sa i kanë hie mësimt të-shën-
2 doshë; — Pleqtë të jenë të-përmbajturë, të-hi-
eshim, të-urtë, të-shëndoshë ndë besët, ndë
3 dashurit, ndë durimt. Gjithashtu edhe plaka-
të të kenë të-sjella sikundrë u ka hie shën-
torëvet; të jenë jo kallëzimtare, jo të-bëra
rop ndë shumë verë, të jenë mësimtare të-
4 mira, Që të mësonjënë të-ratë të duanë bu-
5 rrat' e djem' e tyre, Të jenë të-urta, të-që-
ruara, shtëpiruajtëse, të-mira, të-bindura ndë
burrat të-tyre, që të mos shahetë fjal' e Pe-
6 rëndisë.—Të-rinjte gjithashtu ngut-i të jenë
7 të-urtë; Mbë të-gjihta të-dëftienç vetëhenë
t' ende shëmbëllë punërash të-mira, dyke
8 ruajturë ndë mësimt paprishje, nder, Fjalë të-
shëndoshë e të-padënuarshime, që të turpë-
ronetë ay që është kundrë, e të mos ketë të
9 flasë për ju asndonjë të-ligë. Shërbëtorët t'u
bindenë zotërinjvet të tyre, mbë gjithë pu-
nërat të jenë të-pëlqyershim, të mos fla-
10 sënë kundrë; Të mos e bëjnë të-tyrenë gjën'
e-huaj, po të dëftienjënë çdo besë të-mirë,
që të stolisnjënë ndër gjithë punërat mësimn'e
Perëndisë, Shpëtimtarit t' ënë.

11 Sepse uduk hiri i Perëndisë që sjell
12 shpëtim mbë gjithë njerëzitë, I-cili na mëson
të mohojmë pabesërinë edhe dëshërimet' e
botësë, e të rrojmë me urtësi e me drejtëri
13 e me besë të-mirë ndë këtë jetë, Dyke pri-
turë shpresën' e-lumurë edhe të-dukurit' e
lavdis' së të-madhit Perëndi edhe të Shpë-
14 timtarit t' ënë Jisu Krisht; I-cili dha vetëhen'
e ti për ne, që të na çpërblenjë prej çdo
pau dhërie, edhe të qëronjë për vetëhen' e ti
një llaus të-sgjedhurë, zëmërrë-përvëluarë për
punëra të-mira.
15 Këto folë, e porosit, e qërto me çdo pu-
shtet; asnjëri letë mos të hedhë ty poshtë.

Krye 3.

1 Bjer'u'a ndër mentt atyreve të unjënë
kryetë ndënë urdhërat e ndënë pushtetet, të
bindenë ndër ata, të jenë gati për çdo punë
2 të-mirë, Asnjëri të mos shanjënë, të mos
zihenë, të jenë të-butë, dyke rrëfyerë çdo
3 butësirë mbë gjithë njerëzitë. Sepse edhe
neve ishimë njëherë të-marrë, të-pabindurë,
të-gënjyerë, dyke shërbyerë dëshërimëve të-
ndryshm e kënaqjeve, dyke shkuarë jetënë
ndë të-ligë e ndë cmir, të-mërziturë e dyke
pasurë mëri njëri jatërinë.
4 Po kur uçaq mirësia edhe dashuria mbë
5 njerëzitë e Shpëtimtarit t'ënë Perëndi, Jo prej
punërash drejtërie që punuamë neve, po pas

- përdëllimit të ti na shpëtoj, me anë të të-larit të përsërilindjesë, edhe me anë të të-përtërijturit të Frymës' së-Shënjtëruarë, Që derdhi me dorë të-hapëtë mbi ne me anë të 7 Jisu Krishtit, Shpëtimtarit t' ënë; Që, pasi të dalëmë të-drejtë me anë të hirit t' ati, të bë-nemi trashëgimtarë pas shpresës' së jetës' së-përjetëshme.
- 8 Për të besuar' është fjala; edhe këto dua t'i vërtetonjç, që të kujdesenë ata që i kanë besuarë Perëndisë të jenë të-parë për punë-ra të-mira. Këto janë të-miratë e të-dobi-9 shimetë mbë njerëzitë. Po kërkuarje të-marra, e breza njerëzish, e grindje, edhe luftëra nomi, *këto* i largo; sepse janë të pa-dobishi-me edhe të-kota.
- 10 Nga njeriu eretik, si t'a mësonjç një herë 11 e dy herë, hiq dorë, Dyke diturë se i-këtilli është' i-prishurë, edhe fëjen, sepse e ka dënu-arë vetë vetëhenë.
- 12 Kur të dërgonj Artemanë a Tihikunë te ti, çpejto të vinjç tek unë ndë Nikopolë, sepse 13 atje vendosa të-dimëronj. Nomtarinë Zina edhe Apollonë përcill-i me kujdes, që të mos ushteretë atyre asgjë.
- 14 Edhe letë nxënë edhe t' anëtë të jenë të-parë për punëra të-mira për nevojat' e ne-vojshime, që të mos jenë të-papemshim.
- 15 Të falenë me shëndet gjith' ata që janë

bashkë me mua. Fal-u me shëndet atyreve që na duanë ndë besët.

Hiri *qoftë* bashkë me gjithë ju. Amin.
